



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 12.05.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 04.02.2008 “Për standardizimin”, i ndryshuar”.
2. Raporti i Ministrisë së Drejtësisë për inspektimet në prokurori për vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Xhemal Qefalia.

Mungojnë: Silva Caka, Dashamir Peza.

Të ftuar:

Ervin Mete - zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Riza Hasanaj - drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS)

Kostanca Dedja - drejtore për Çështjet Ligjore dhe Marrëdhëniet me Palët në DPS

Ardit Çollaku - këshilltar i Ministrit

Nasip Naço – ministër i Drejtësisë

Sokol Pasho - drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë

Edlira Bako - drejtore e Inspektimit të gjyqësorit dhe prokurorisë pranë Ministrisë së Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Si pikë e parë e rendit të ditës është projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 04.02.2008 “Për standardizimin”.

Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes i pranishëm është zoti Mete, zëvendësministër në këtë ministri.

Zoti Mete, të lutem një përmbledhje të projektit dhe qëllimit.

Ervin Mete – Faleminderit, zoti kryetar!

Shkurtimisht ndryshimet janë minore dhe synojnë të harmonizojnë këtë ligj me ndryshimet që janë bërë në ligjet e tjera, por në direktiva europiane. Praktikisht ndryshimi i parë ka të bëjë me ndryshimet që janë bërë në ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, ku me ato ndryshime dhe Drejtoria e Standardizimit ka marrë dhe do të trajtohet në bazë të statusit të nëpunësit civil, çka do të thotë që nevojitet një ndryshim në këtë ligj për ta harmonizuar me ligjin bazë, dhe nga ana tjetër ka një ndryshim në direktivën që trajton njoftimin që bëjnë trupat standardizuese të vendeve aspirante siç jemi ne, në lidhje me draft standardet që do të adoptohen nga to dhe këtë njoftim e bëjnë në Bruksel.

Ka një ndryshim në direktivën përkatëse të njoftimit, ku është shfuqizuar pika që ne kishim vendosur në ligj, dhe rrjedhimisht e shfuqizojmë edhe në këtë pikë, dhe njoftimi tani bëhet tek trupat e tjerë që rregullohen nga direktiva, pra janë vetëm këto dy pika që e sjellin këtë ligj në linjë me ligjet e tjera.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Siç e tha edhe zëvendësministri, janë disa ndryshime të natyrës teknike që të përputhen me *acquis communautaire* dhe me ligjin “Për shërbimin civil”.

A ka ndonjë pyetje? Nuk ka. Diskutime nuk ka.

Kush është dakord?

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Neni 3. Dakord.

Jeni dakord me projektligjin në tërësi? Në tërësi. Dakord.

Faleminderit!

Zoti zëvendësministër, faleminderit.

Ju uroj gjithë të mirat!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 12.05.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raporti i Ministrisë së Drejtësisë për inspektimet në prokurori për vitin 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Xhemal Qefalia.

Mungojnë: Silva Caka, Dashamir Peza.

Të ftuar:

Nasip Naço – ministër i Drejtësisë

Sokol Pasho - drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë

Edlira Bako - drejtore e Inspektimit të gjyqësorit dhe prokurorisë pranë Ministrisë së Drejtësisë

Fatmir Xhafaj – Pika e dytë e rendit të ditës është raporti i Ministrisë së Drejtësisë për inspektimet në prokurori për vitin 2014. I pranishëm është ministri i Drejtësisë, zoti Nasip Naço.

Faleminderit, zoti Ministër! Bashkë me të është drejtori i Përgjithshëm i ministrisë, zoti Pasho, dhe zonja Bako, drejtore e Inspektimit të gjyqësorit dhe prokurorisë.

Fillimisht do të dëgjojmë materialin e sjell nga Ministria e Drejtësisë, i cili u është shpërndarë kolegëve deputetë, por gjithsesi një paraqitje e ministrit dhe pastaj do të bëhen pyetjet përkatëse.

Zoti Ministër!

Nasip Naço – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Komisionit të Ligjeve,

Të nderuar anëtarë të maxhorancës dhe të opozitës,

Në përmbushje të detyrimit ligjor, ndodhem sot para këtij komisioni për të prezantuar konstatimet e Inspektoratit të Ministrisë që unë drejtoj në lidhje me inspektimet e kryera në organin e prokurorisë për periudhën 1 mars 2014 – 1 mars 2015.

Duke qenë se kontrolli që bëhet është i jashtëm, inspektimi i Ministrisë së Drejtësisë vlerësohet si një mundësi për të siguruar harmonizimin e veprimtarisë së pushteteve dhe sigurimin e ekuilibrit dhe bashkërendimin në funksion të politikës penale shtetërore. Raportet e inspektimit të kryer nga ana jonë, kanë adresuar faktet dhe konstatimet gjatë veprimtarisë së këtij institucioni, ku nëpërmjet këtyre konstatimeve mund të nxirren rekomandime për politikën dhe aktivitetet që duhen ndërmarrë në përputhje me vizionin dhe prioritetet për sistemin e drejtësisë.

Gjatë periudhës së raportimit janë ushtruar kontrolle të planifikuara mbi bazë ankese, siç janë ato në shkallë të parë dhe në atë të apelit. Kontrollat e planifikuara janë ushtruar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë dhe prokurorinë e Apelit Shkodër, ndërsa kontrolli mbi bazë ankese është ushtruar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës. Në këndvështrimin statistikor, përgjatë kontrolleve të ushtruara, janë inspektuar rreth 1200 procedime penale, nga të cilat rreth 830 procedime i përkasin prokurorisë së shkallës së parë dhe rreth 370 procedime i përkasin prokurorisë së apelit. Në inspektimin e çështjeve në prokurorinë e shkallës së parë në fokus ka qenë ligjshmëria e veprimtarisë së prokurorit lidhur me respektimin e afateve të hetimit, respektimin e afateve të paraburgimit, rregullshmërinë dhe vijueshmërinë e veprimeve hetimore,

respektimin e të drejtave të njeriut dhe subjekteve të procedimit penal, në veçanti të ndaluarve, të arrestuarve sidomos ata që janë të mitur.

Për sa i takon inspektimit të realizuar në prokurorinë e apelit, në fokus ka qenë ndjekja e ecurisë së çështjeve që përmbanin rekomandimet vjetore të dhëna nga Këshilli i Ministrave, në luftën kundër kriminalitetit për sa i takon politikës penale të ndjekur. Inspektimet e zhvilluara në periudhën e raportimit kanë mbuluar përgjithësisht procedimet penale të dy vjetve të fundit, ku bazuar në raportin e kontrollit Ministri i Drejtësisë i ka rekomanduar prokurorit të Përgjithshëm fillimin e procedimit disiplinor për 6 prokurorë, veprimtaria e të cilëve është konstatuar me shkelje të detyrës duke marrë në konsideratë parimin e proporcionalitetit dhe të pasojës së ardhur nga shkelja e kryer.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Përgjatë periudhës së raportimit janë konstatuar këto lloj shkeljesh: shkelje e detyrimit për veprime të rregullta të vijueshme hetimore, kjo shkelje është evidentuar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë, ku ka rezultuar se ka periudha të gjata kohore gjatë të cilave pa asnjë shkak të dukshëm ligjor nuk janë kryer veprime hetimore, por janë zvarritur hetimet jashtë një afati të arsyeshëm ligjor; nuk janë kryer veprime hetimore në përmbushje të detyrave të lëna nga gjykata, pasi kjo e fundit ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit; ka munguar roli mbikëqyrës i prokurorit lidhur me veprimet e deleguara oficerit të Policisë Gjyqësore. Në referim të konstatimeve kam rekomanduar:

1. Shfuqizimin e vendimeve të konstatuara me shkelje.
2. Fillimin e procedimit disiplinor për prokurorët e kontrolluar, veprimtaria e të cilëve është konstatuar me shkelje të detyrës.

Shkelje të detyrimit ligjor të prokurorit për fillimin e ndjekjes penale.

Kjo është evidentuar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë dhe Durrës dhe konkretisht: mosfillim procedimi, ndërkohë që kallëzohen veprime korruptive të personave konkret pa u kryer asnjë verifikim apo veprim proaktiv nga prokurori; mosfillim procedimi për shkak se kallëzimi nuk është paraqitur, ndërkohë që ky shkak nuk përfshihet në rrethanat, të cilat nuk lejojnë fillimin e procedimit; mosfillim i procedimit, megjithëse janë kryer veprime të mirëfillta hetimore apo kur nga materiali kallëzues del e domosdoshme kryerja e veprimeve hetimore për të provuar apo rrëzuar pretendimet e paraqitura.

Rekomandimi i dhënë nga Ministri i Drejtësisë për këtë natyrë shkeljesh ka qenë:

1. Shfuqizimi i vendimeve të konstatuara me shkelje, për rastin e konstatuar në prokurorinë e shkallës së parë Durrës. Ky rekomandim u konsiderua i drejtpërdrejtë nga drejtuesi i prokurorisë së rrethit Durrës, i cili vendosi shfuqizimin e vendimit të konstatuar me shkelje.

2. Fillimin e procedimit disiplinor për prokurorët e kontrolluar, veprimtaria e të cilëve është konstatuar me shkelje të detyrës.

3. Shkelje e detyrimit për ndjekjen e një politike të drejtë penale dhe në veçanti të politikës së dënimit.

Kjo natyrë shkeljeje është evidentuar në prokurorinë e apelit Shkodër për çështjet që përmbanin rekomandimet vjetore të dhëna nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit. Rekomandimet e ministrit të Drejtësisë për vitin 2014, kanë orientuar ashpërsimin e kërkesave të prokurorëve për veprat penale që parashikojnë një masë dënimi në minimum mbi 5 vjet burg, dhe në veçanti për veprat penale të korrupsionit, të krimit të organizuar, të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të ndërtimit të paligjshëm, vjedhjes së energjisë elektrike, krimet kundër mjedisit etj.

Në vështrimin e këtyre rekomandimeve, është analizuar përfaqësimi në gjykim i prokurorisë së apelit Shkodër, ku u evidentua ndër të tjera se pavarësisht faktit, që prokurori i shkallës së parë ka bërë ankim lidhur me masat e dënimit të dhënë nga gjykata, prokurori i apelit ose nuk e ka ashpërsuar masën e dënimit ose nuk ka bërë rekurs, ku gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Rekomandimi i dhënë për këtë shkelje ka qenë, që gjetjet e këtij raporti të konsiderohen si në drejtim të politikave, të promovimit dhe disiplinimit të prokurorëve, por edhe për unifikimin dhe orientimin e politikës penale që duhet të ndiqen nga prokurorët, specifikisht për ecurinë e çështjeve që përmbajnë rekomandimet vjetore të dhëna nga Këshilli i Ministrave në luftën kundër kriminalitetit.

4. Shkelje e detyrimit ligjor për respektimin e parimit të ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorit, në marrëdhëniet e tij me subjektet e tjera të procedimit penal.

Kjo shkelje është evidentuar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë dhe konkretisht: nuk është respektuar detyrimi për njoftimin e vendimit të mosfillimit të kallëzuesit në 26 raste të konstatuara në prokurorinë e rrethit Sarandë; nuk është respektuar detyrimi për njoftimin e vendimit të pushimit personave të interesuar në 6 raste, po në prokurorinë e rrethit Sarandë.

Të nderuar deputetë,

Nga ankesat drejtuar Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet portalit “Stop korrupsionit në drejtësi” apo edhe në rrugë shkresore, ku janë denoncuar për veprime korruptive punonjës të sistemit të drejtësisë apo institucioneve të tjera, rreth 26 raste i kanë kaluar për kompetencë trajtimi për kryerje të hetimeve të mëtejshme proaktive zyrës së prokurorit të Përgjithshëm. Nga rreth 26 rastet e përmendura më sipër, për 5 prej tyre prokurori i Përgjithshëm ka urdhëruar dërgimin për kompetencë hetimi prokurorisë së shkallës së parë, për të cilat është vendosur: në dy raste mosfillimi i procedimit, në një rast pushim i hetimit, në një rast prokurori ia ka përcjell materialin Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Ministrisë së Brendshme dhe në një rast materiali është në proces verifikimi.

Duke analizuar këto shifra, i kam kërkuar prokurorit të Përgjithshëm në rekomandimet e vitit 2015, që të ndërmarrë sa më shumë hetime proaktive. Mungesa e hetimeve proaktive është një fakt që vazhdon të evidentohet në raportimet e institucioneve ndërkombëtare, që monitorojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Progresraporti për vitin 2014, lidhur me luftën kundër korrupsionit, adreson se hetimet vazhdojnë të jenë më shumë të nxituara sesa kryesisht, dhe numri i dënimeve të formës së prerë mbetet i ulët në të gjitha nivelet. Më shumë punë kërkohet për të rritur efencën e hetimeve dhe për t'i bërë ato më proaktive përfshi edhe hetimet financiare, dhe hetimet për korrupsion në nivelin e lartë, korrupsion në sistemin e drejtësisë, konfliktin e interesit dhe mashtrimin në deklarin e pasurisë.

Në përfundim të fjalës sime dëshiroj të ritheksoj edhe një herë se në procesin e realizimit të angazhimeve të qeverisë shqiptare për forcimin e shtetit të së drejtës dhe për të garantuar pavarësinë, efencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve, nga Ministria e Drejtësisë ka vazhduar dhe do të jetë prioritet, që t'i kërkojë Prokurorisë së Përgjithshme forcimin e pavarësisë dhe integritetit të prokurorëve në procesin e hetimit dhe përmirësimin e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale, dhe për këtë në emër të qeverisë shqiptare i kemi rekomanduar zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, forcimin e integritetit dhe autonomisë për prokurorët në hetimin paraprak, rritjen e hetimeve proaktive, zbatimin e kuadrit ligjor, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si një premisë bazë për suksesin e veprimtarisë të organit të prokurorisë, forcimin e kompetencave, të transparencës në këshillat e prokurorisë në raport me emërimin, promovimin, transferimin dhe procedimin disiplinor të prokurorëve.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Dëgjuam një përmbledhje të raportit të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë mbi inspektimet e kryera nga ministria në prokurori për periudhën e vitit të kaluar. Raportin, si dhe përmbledhjen ose vlerësimin e shërbimit të monitorimit të institucioneve të pavarura, ju i keni. Ky raportim i paraprin raportimit që do të bëjë prokurori i Përgjithshëm, prandaj sot jemi për të parë vetëm raportin e Ministrisë së Drejtësisë, inspektimin e saj në prokurori dhe efektet e këtij monitorimi.

Kush ka pyetje?

Zoti Majko!

Më pas zoti Mediu dhe zoti Manja.

Pandeli Majko – Unë kam një pyetje. Zoti Ministër, këtu po shoh që në raportimin tuaj shumë konciz, janë kryer gjatë vitit që ju raportoni gjithsej 3 kontrolle, 2 kontrolle të planifikuara dhe 1 kontroll mbi bazë ankese. Do t’ju lutesha të më shpjegoni, mbase unë jam deri diku i paqartë, dhe ndoshta duhet të më jepni pak më tepër informacion lidhur me pyetjen time, e cila mund të ketë edhe doza naiviteti, vërtet ka pasur vetëm një kontroll mbi bazë ankese. Pra vetëm një ankesë ka pasur dhe ju keni bërë një kontroll? Pse e them këtë? Po vazhdoj me pyetjen tjetër pasi shoh një diferencë, dje kishim Avokatit e Popullit, i cili në raportin e tij na tha që institucioni i Avokatit të Popullit po e citoj: “Ka trajtuar 304 ankesa të adresuara nga qytetarët për veprime të padrejta ose mosveprime të kryera nga organi i akuzës dhe veprime të kryera nga gjykata”, mbyllet citimi i raportimit të tij.

Tani 304 ankesa janë drejtuar për mosveprim apo veprime të gabuara në prokurori dhe gjykatë Avokatit të Popullit. Ju, gjatë 1 viti keni bërë 1 kontroll mbi bazë ankese. Do t’ju lutesha të më shpjegoni, mbase është vetëm matematikë dhe detajet i dini ju si ministër dhe si Ministri e Drejtësisë. Sigurisht, do të kërkoja edhe një reflektim tuajin si institucioni i Ministrisë së Drejtësisë, duke pasur parasysh që aktualisht ne të gjithë jemi në kulmin e diskutimit të reformës së drejtësisë, dhe ta lidhni këtë raportim edhe me disa identifikime apo evidencime që ka bërë edhe progresraporti i Bashkimit Europian, pasi duam apo nuk duam ne, të gjitha këto janë në funksion të këtij udhëzuesi, që duhet progresraporti, ku janë identifikuar, dhe problemi i sistemit të drejtësisë është trajtuar si më problematiku.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Zoti Ministër, ju lutem përgjigjen!

Nasip Naço – Faleminderit!

Nga Ministria e Drejtësisë ishin planifikuar që të bëheshin 4 kontrolle, në prokurorinë Shkodër, Mat, Sarandë dhe Vlorë. Kontrolli i përgjithshëm u ushtrua në prokurorinë e apelit në Shkodër, është ushtruar kontrolli edhe në prokurorinë e rrethit Sarandë, është dërguar grupi i inspektimit në prokurorinë e rrethit të Vlorës, por paralelisht me ne ka qenë edhe kontrolli i ushtruar nga zyra e prokurorit të Përgjithshëm, dhe sigurisht që ne jemi tërhequr nga këto kontrolle që kishim, për të mos dubluar të njëjtin kontroll. Kemi parë me përparësi rastet dhe ankesat, që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ndoshta është e vërtetë që Avokati i Popullit mund të ketë rreth 360 ankesa, por nuk jemi fokusuar dhe nuk kemi dashur të dublojmë punën e zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, drejtorinë përkatëse që ka zyra e prokurorit të Përgjithshëm për të ushtruar kontrolle dhe për të verifikuar ankesat në çdo rast.

Sigurisht që unë në punën time si ministër i Drejtësisë nuk e kam parë këtë mjet ligjor që ta kem si çekiç ndaj prokurorisë, dhe nuk kam dashur të dublojë punën e saj, pasi nga përvoja ime si drejtues i prokurorisë për më pak se një vit e gjysmë më kanë ardhur 30 herë për kontroll nga Ministria e Drejtësisë dhe nuk jepeshin asnjëherë rezultatet e kontrollit, sepse në të njëjtën kohë dhe paralelisht kontrolli bëhej në gjykatë, bëhej edhe nga zyra e prokurorit të Përgjithshëm.

Rekomandimet dhe fokusi ynë ka qenë në luftën ndaj korrupsionit, ku edhe në një pjesë të raportit në fjalën time unë përmenda, që në rreth 26 raste ankesash të adresuara në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet portalit apo ankesa të ndryshme, ne ia kemi adresuar zyrës së prokurorit të Përgjithshëm për të kryer veprime proaktive, sigurisht ato janë shqetësime apo ankesa dhe nuk janë në formën e kërkuar nga ligji, në formën e një kallëzimi të mirëfilltë, por kur thuhet që një prokuror më ka kërkuar 3 mijë euro, një gjyqtar më ka kërkuar atë apo diçka tjetër, ne kemi qenë tejet të shqetësuar dhe kemi vënë në dijeni zyrën e prokurorit të Përgjithshëm për të bërë veprimet e tjera së bashku me policinë, pasi mjetet tona kaq janë, shqetësimet e ardhura nga qytetarët nëpërmjet këtij portali të sensibilizuar po nga Ministria e Drejtësisë ia kemi dërguar zyrës së prokurorit të Përgjithshëm.

Sigurisht që ata e kanë parë në një këndvështrim tjetër, që ankesa nuk i përmban të gjithë ato elemente që përmban Kodi i Procedurës Penale dhe nuk kanë ushtruar dhe kryer hetime proaktive, unë besoj që i kam përmendur në të gjitha rastet, sigurisht duke parë dhe rekomanduar që për vitin 2015, në fokusin tonë nuk do të jenë më kontrollet tematike apo ankesa të veçanta, por do të përqendrohemi te lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, për t'i kërkuar në çdo rast

jo vetëm zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, por, nëse vjen një ankesë apo një kallëzim i tillë paralelisht, nuk do ia dërgojmë vetëm zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, por edhe strukturave të tjera ligjzbatuese që të mos ngelet në zyrën e prokurorit të përgjithshëm.

Ju e dini tashmë, që nisma që mori maxhoranca për krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, fatkeqësisht është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese, dhe besoj se aty parashikohej qartë dhe fokusi ishte lufta ndaj korrupsionit dhe veprave penale të lidhura me to kudo që të shfaqeshin nga zyrtarët e lartë. Unë besoj se deri në zbardhjen e vendimit Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme do ta shikojë me vëmendje për të fokusuar të gjithë veprimtarinë e saj në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Në vijim të asaj që ngriti edhe kolegu Majko, ju keni bërë tri, katër kontrole dhe i bie që në një mandat ministri 4-vjeçar, po të ecësh me këtë ritëm, që gjithsej mund të jenë rreth 15, 16 prokurori që kontrollohen në një kohë që janë shumë më tepër. Pra, shihet një mospërputhje e mandatit të ministrit me volumin e kontrollit që duhet kryer për të pasur atë efektivitet në punën tuaj apo kontrollin mbi prokurorinë, siç e paraqitët edhe ju, e para.

E dyta, shoh që kohëzgjatja në kontroll, në Sarandë, ka qenë 5 muaj, në Shkodër rreth 9 muaj, në qoftë se nuk e kam gabim nga leximi, ka të bëjë me mundësitë njerëzore për të ushtruar këtë kontroll dhe më pas problemet e tjera që vijnë për shkak edhe të kohëzgjatjes, pasi ju thatë, që, kur keni qenë ju drejtues prokurorie, keni pasur rreth 30 kontrole në vit, kurse kështu i bie që 2/3 e vitit të jenë me një kontroll në një prokurori, siç është ajo e Shkodrës.

Nasip Naço – Faleminderit për pyetjen, zoti Mediu!

Do të ndajmë bashkërisht kontrollin nga verifikimi që bëhet nga inspektimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe, ju them që ankesat që vijnë në këtë ministri janë gati të barabarta me ato që venë në Këshillin e Ministrave, të cilat vijnë edhe për sistemin e drejtësisë, por ne dimë të ndajmë pjesët për t'i verifikuar nga pjesa e kontrollit. Pak më parë ju thashë që nuk e kam konceptuar inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë si mjet presioni ndaj zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, apo prokurorëve të veçantë për të ushtruar kontrole të veçanta, sepse kam kërkuar në çdo rast bashkërendimin, inkurajimin e zyrës së prokurorit të Përgjithshëm për më shumë hetime proaktive, për të hetuar çështje të natyrës që do t'i rikthenin besimin sistemit të drejtësisë. Në fokus të këtyre

kontrolleve dhe të gjithë veprimtarisë sime ka qenë përqendruar më shumë veprimtaria ndaj kriminalitetit, por dhe veprimtaria ndaj gjyqtarëve sesa ajo ndaj prokurorëve, pasi në perceptimin tim kjo pjesë ka funksionuar më mirë se pjesa tjetër e sistemit gjyqësor, por kjo nuk do të thotë që për vitin 2015 nuk kemi parashikuar qoftë rritjen e kapaciteteve, riorganizimin brenda Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet inspektoratit dhe përthithjen e magistratëve, prokurorë në inspektimin e Ministrisë së Drejtësisë, të cilin për fatin e keq, do të thosha i gjeta në një gjendje ku të gjithë ata që punonin në këtë drejtori apo sektorë vetëm njëri kishte punuar në prokurori dhe pjesa tjetër kanë punuar në administratë dhe kanë statusin e nëpunësit, janë shumë të kualifikuar, por nuk kanë eksperiencën e duhur në drejtim të prokurorisë.

Ne e kemi parë edhe këtë aspekt që të tërheqim prokurorë e magistratë në drejtim të inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë. Unë besoj, pasi siç e thashë edhe pak më parë, kjo është çështje edhe koncepti, por dikush tjetër mund të ushtronte të gjithë veprimtarinë ndaj kontrollit të prokurorisë, por duhet të kemi parasysh që do të harxhonim forca dhe energji, kur ne e dimë që zyra e prokurorit të Përgjithshëm ka një drejtori që bën kontrolle të trefishta, sepse kontrollet janë bërë nga ne, kontrollet bëhen nga gjykata, kontrollet bëhen nga zyra e prokurorit të Përgjithshëm, janë kontrolle tematike mbi bazën e ankesave, pra është detyrim ligjor që zyra e prokurorit të Përgjithshëm një herë në dy vjet të kontrollojë të gjitha prokuroritë dhe nuk do të donim që të harxhonim energji duke dubluar inspektoratet midis tyre, por kemi kërkuar bashkëpunimin midis këtyre inspektorateve, gjithashtu kemi kërkuar dhe inkurajuar që prokuroria të bëjë punën e vet dhe qeveria të ndihmojë në çdo rast, të koordinojë bashkë me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe të mos bëhet pengesë për prokurorinë.

Kërkesës së parë që më erdhi nga prokurori i Përgjithshëm për të shtuar numrin e prokurorëve, unë sigurisht që i jam përgjigjur menjëherë. Duhet të kemi parasysh se që nga viti 2002 pas kërkesave që bënin prokurorët e përgjithshëm, asnjë ministër i Drejtësisë nuk kishte dhënë pëlqimin për të shtuar numrin e prokurorëve. Ne duke parë rritjen e punës dhe impenjimin e zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, sigurisht duke u konsultuar edhe me ministrin e Financave dhe me Kryeministrin, kemi dhënë pëlqimin për t'i shtuar zyrës së prokurorit të Përgjithshëm edhe 6 prokurorë të tjerë për të forcuar kapacitetet dhe burimet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Fatmira Xhafaj - Faleminderit! Zoti Manja, ka fjalën dhe më pas zonja Hysi!

Fatmir Mediu - Atëherë thuhet: Vendi i ushtrimit të kontrollit dhe periudha: Kontrolli i planifikuar i ushtruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë më datë 01.01.2013 dhe 31.05.2014, pra i bie gati 5 muaj.

Edlira Bako - Koha e ushtrimit të kontrollit në të dyja prokuroritë është dy javë.

Nasip Naço – Për të qenë më i saktë zoti Mediu, mund t'ju vëmë në dispozicion edhe dietat që kanë marrë punonjësit.

Fatmira Xhafaj - Faleminderit! Po, zoti Manja!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë në cilësinë e relatorit, por edhe për shkak të natyrës së veçantë të këtij raportimi, jam njohur me raportin e ministrit të Drejtësisë, në lidhje me inspektimet e kryera nga Ministria e Drejtësisë për në prokuroritë për periudhën në fjalë. Siç e tha edhe zoti ministër, kontrolli i Ministrisë së Drejtësisë është formë e jashtme e kontrollit mbi institucionin e prokurorisë.

Zoti Ministër, në të gjitha raportet e BE-së prokuroria shqiptare kritikohet se vuan nga mungesa e transparencës në ushtrimin e aktivitetit të saj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Sigurisht, kontrolli që ju ushtroni është një nga format e jashtme të kontrollit dhe po të shohim edhe ligjin për formën e kontrollit që ju ushtroni mbi prokurorinë kryesisht i referohem zbatimit të ligjshmërisë në veprimtarinë e punës së prokurorëve sepse kontrolli i Ministrisë së Drejtësisë shtrihet vetëm mbi çështjet e pushuara, pezulluara dhe për çështjet për të cilat ka një vendim gjykatë të formës së prerë, pra, nuk prek çështjet që janë një hetim dhe në gjykim. Jo më kot fokusi i kontrollit shtrihet mbi ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve dhe kryesisht në lidhje me respektimin afateve të hetimit, respektimin e afateve të paraburgimit, në dinamikën e kryerjes së veprimeve hetimore si edhe në respektimin e detyrimit ligjor për fillimin e ndjekjes penale.

Hetimi ka tri karakteristika kryesore: shpejtësi, objektivitet dhe paanshmëri. Sigurisht, mungesa e ligjshmërisë në ushtrimin funksioneve të një prokurori, sipas gjykimit tim, vjen për shkak të dy cilësive: ose një prokuror është i paaftë ose ky prokuror është i korruptuar, sepse të zvarrësish hetimet, të mos respektosh afatet e hetimit, të mos respektosh afatet e paraburgimit, të mos kryesh veprime hetimore në dinamikë në lidhje me një hetim ose je i paaftë, ose je i korruptuar.

Nisur nga ky shqetësim që ka opinionin publik, por edhe miqtë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë lidhur me aktivitetin e prokurorisë. A mendoni ju, se duhet rritur roli i Ministrisë së Drejtësisë, i kësaj zyre të Drejtorisë së Inspektimit? Gjithmonë në stadin aktual ku e kemi prokurorinë dhe gjithmonë në funksion të transparencës, lidhur me ligjshmërinë e veprimtarisë së

prokurorëve dhe pa prekur pjesën, për të cilën na ndalon parimi kushtetues i pavarësisë së institucionit. Pra, si e mendoni rolin e Ministrisë së Drejtësisë në drejtim të ushtrimit të kësaj forme të kontrollit mbi institucionin e prokurorisë?

Pyetja e dytë. Janë ushtruar dy kontrole me tematikë të përcaktuar në Sarandë dhe në Shkodër dhe sigurisht në përfundim të këtyre kontrolleve ju keni bërë rekomandimet e duhura për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme. Nisur nga natyra e rekomandimeve që keni bërë, sa prej këtyre rekomandimeve janë marrë në konsideratë nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme? Në rekomandimet që ju keni bërë për prokurorin e Përgjithshëm, a ka pasur rekomandime të karakterit ekstrem, për shembull largim të prokurorëve nga detyra?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja! Zoti ministër për komentet dhe dy pyetjet e zotit Manja!

Nasip Naço – Në lidhje me pyetjen e parë unë pak a shumë iu përmbajta edhe në fjalën time, por edhe në dy përgjigjet që dhashë për zotin Majko dhe për zotin Mediu.

Unë si ministër i Drejtësisë, nuk kam kërkuar asnjëherë që të dubloj institucionet e tjera dhe mund të them se, ndryshimet dhe burimet njerëzore gjatë kësaj periudhe i kam përdorur më shumë ndaj gjyqtarëve sesa ndaj prokurorëve për shkakun që e shpjegova pak më sipër, që zyra e prokurorit të Përgjithshëm ka një drejtori të veçantë për ushtrimin e kontrollit tematik që bën me bazë të kërkesave, por edhe vetë kontrollit që gjykata i bën prokurorisë në të gjitha shkallët e saj dhe nuk e kam parë si një mjet që të dublojmë këtë veprimtari dhe të harxhojmë energji në këtë drejtim.

Të gjitha burimet njerëzore dhe kapacitetet i kam përdorur më shumë në lidhje me inspektimet në gjykata apo përgatitjen e materialëve, që i janë dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë. E them këtë për arsye se në një vit e gjysmë janë dërguar rreth 27 procedime disiplinore dhe në këtë drejtim përsëri pjesën më të madhe të kontrolleve janë bërë nga inspektimi pranë KLD-së dhe nga inspektimi pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në dy apo në tri raste është inspektuar direkt për shkak të ankesave të bëra nga inspektimi i ministrisë dhe ju do të shikoni që në çdo raport, dhe çdo ankesë, çdo takim me përfaqësues të tjerë, duke filluar nga kryetari i KLD-së, thonë të gjithë se nga qeveria po ushtrohet presion mbi gjyqësorin. Këtë fakt e thashë pasi tashmë është bërë publike për arsye sepse jam munduar që t'i ruhem këtij shantazhi që është bërë nga këto institucione duke i bërë në çdo rast qeverisë apo që ushtron presion ndaj gjyqësorit.

Unë jam munduar të bashkërendoj punën me këtë inspektorat, qoftë më KLD-në, qoftë me zyrën e prokurorit të Përgjithshëm, për kontrolle të përbashkëta që qeveria në emër të ministrit të Drejtësisë dhe këtij inspektorati të mos e kaloj cakun, për të cilën do të thosha që nuk ka ndonjë vijë të përcaktuar qartë për çështje perceptimi për ministrin e Drejtësisë, për stafin, për opinionin publik, por edhe për institucionet ligjzbatuese.

Sigurisht që shumë gjëra nuk kanë funksionuar siç duhet dhe siç do të dëshironim nga këto dy inspektorate dhe ajo që përmenda edhe dy ditë më parë në ditën e drejtësisë për sa i përket sistemit gjyqësor, është që Ministria e Drejtësisë nëpërmjet inspektoratit të saj do të fokusohet drejt atyre gjyqtarëve që janë të paprekshëm, në kuptimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ndaj atyre prokurorëve që janë të paprekshëm ndaj zyrës së prokurorit të Përgjithshëm. Kjo e thënë këtu publikisht ka edhe një kosto, që sigurisht do ta marrim përsipër sepse duam që kjo të funksionojë dhe të jemi përballë qytetarëve, përballë publikut, por edhe parterëve tanë ndërkombëtarë, në mënyrë që të mos bëhen kontrolle ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve periferik, por të jenë atje ata që për ne quhen të paprekshëm.

Besoj se mbi bazën e një riorganizimi të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe të këtij inspektorati sigurisht që për vitin 2015 vërejtjet dhe sugjerimet tuaja do të merren parasysh në ushtrimin e veprimtarisë së këtij inspektorati, por edhe në vazhdimësi duke bashkëpunuar me këto institucione.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar! Faleminderit, zoti Ministër!

Kam lexuar raportin dhe relacionin që ka përgatitur Shërbimi i Monitorimit të institucionit të pavarur të Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë fjalës suaj ju gjithë kohës thoni, që jeni treguar i kujdesshëm për të mos dhënë përshtypjen ose për të ushqyer atë idenë që mund të kenë prokurorët që qeveria kontrollon.

Pyetja e parë ka të bëjë pikërisht me përmbajtjen e nenit 56, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”. Në dijeninë tuaj nga kontrolli që keni bërë, a i njohin prokurorët kompetencat që ju jep ligji ju për të kontrolluar ecurinë e politikës penale, veçanërisht të politikës së dënimit, për faktin që ju keni të drejtë të kontrolloni kur çështja nuk është në hetim, pra kur ka përfunduar hetimi paraprak?

Pyetja e dytë ka të bëjë me inspektimin që keni bërë në Prokurorinë e Shkallës së Parë Sarandë. Të them të drejtën këto shifra janë të frikshme. 61 çështje për mosfillim procedimi, 119

procedime të pushuara. A ka një analizë të shkaqeve të mosfillimit të çështjeve penale në këtë prokurori dhe të faktit se pse janë të pushuara këto 119 çështje?

Lidhur me Prokurorinë e Apelit Shkodër, sipas raportit tuaj, mua situata më rezulton edhe më skandaloze. Në këtë prokurori ju keni analizuar 149 raste dhe keni konstatuar që janë pushuar apo nuk janë filluar çështjet për korrupsion, krim të organizuar, vepra penale kundër jetës dhe shëndetit, armëmbajtje pa leje dhe vepra penale të dhunës në familje, por nuk më rezulton sa janë gjetur në shkelje dhe çfarë keni rekomanduar. Pra, nëse në Sarandë rezultojnë që janë 6 prokurorë me shkelje dhe keni reaguar ndaj prokurorit të Përgjithshëm dhe nuk keni pasur reagim prej tij, në rastin e Prokurorisë së Apelit Shkodër thuhet që janë nxjerrë konkluzionet, por nuk dihet nëse janë gjetur prokurorë me shkelje apo jo.

Të pushosh apo të mos fillosh 29 raste të krimeve kundër jetës, 22 raste të çështjeve për krimin e organizuar, 12 raste për korrupsion, 47 raste të armëmbajtjes pa leje, 30 raste të veprave penale të dhunës në familje, për mua këto janë prioriteti i prioriteteve, që ka pasur qeveria për vitin 2013-2014 dhe është shkelje flagrante e kërkesave.

Pyetja e tretë ka të bëjë me faktin që prioritetet e Këshillit të Ministrave për politikën penale. A i bëhen me dije këto prioritetet çdo prokurori të prokurorive të rretheve gjyqësore të apeleve? Pra, si vihen në dijeni prokurorët e për prioritetet e politikës penale? Mua më rezulton sikur ata për këto raste kanë ecur totalisht në drejtim të kundërt me orientimet e politikës penale.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi ! Zoti ministër, keni fjalën!

Nasip Naço – Po e filloj nga pyetja e fundit lidhur me rekomandimet. Sigurisht brenda muajit mars dhe prill i jepen rekomandimet përkatëse zyrës së prokurorit të Përgjithshëm në emër të Këshillit të Ministrave dhe bëhet një mbledhje me të gjithë titullarët dhe drejtuesit e prokurorive të shkallëve të para dhe të apelit.

Ky është formati që u bë vitin që shkoi dhe duke parë që nuk ka gjetur një zbatim në praktikë, bashkë me prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2015 kemi menduar që të bëjmë një mbledhje me të gjithë prokurorët dhe jo vetëm me drejtuesit për të dhënë rekomandimet përkatëse të të gjithë prokurorëve, sepse si duket zinxhiri ndërpritet rrugës dhe për këtë shkak menduam që të bëhet mbledhja e përgjithshme e prokurorëve.

Unë besoj se ndryshe nga viti i kaluar këtë vit raportin dhe rekomandimet, edhe pse nuk ka një bazë ligjore, përveç zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, kemi përgatitur të gjithë materialin

e nevojshëm për t'ua dërguar Konferencës Gjyqësore Kombëtare, Gjykatës së Lartë, gjykatave të apelit dhe të gjithë gjykatave të vendit. Për ta kuptuar më qartë, këto rekomandime nuk janë për çështje të veçanta, por janë rekomandime për politikën penale, që kërkon qeveria ndaj prokurorisë dhe sigurisht kërkon mbështetjen e tyre nga gjykata, pasi rekomandimet i jepen vetëm zyrës së prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorëve dhe nuk kanë pasur lidhje me gjykatën. Pra, këto rekomandime do t'i dërgohen KLD-së si edhe të gjitha gjykatave të vendit për t'i parë, për t'i çmuar dhe për të kuptuar dhe ata vetë, se cila është politika e qeverisë, e cila përfaqësohet nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, por edhe për t'u zbatuar nga gjykatat. Po të shikoni të dhënat do të kuptoni qartë që vetëm të mitur janë mbi 840 të dënuar në mos gaboj dhe një pjesë madhe e tyre 43% janë vetëm për veprën penale të “Vjedhjes” dhe mbi 340 apo mbi 400 nuk kanë qenë me dënime alternative, por janë me masë sigurimi “arrest në burg” dhe tani janë në burg.

Këto janë çështje, që ne kemi kërkuar dhe orientuar për një politikë ndryshe dhe nga prokuroria, por që duhet të ndiqen dhe të mbështeten edhe nga gjykata, se në fund të fundit vendimin e merr gjykata përveç kërkesës që bën prokuroria. Unë besoj që këtë material dhe këto rekomandime t'ua vëmë në dispozicion edhe gjykatave.

Ne i kemi theksuar edhe prioritetet, të cilat janë vendosur. Përveç rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar qeveria, ka edhe disa prioritete siç është vjedhja e energjisë elektrike, krimi ndaj mjedisit, ndërtimit të paligjshëm, të cilat ne kërkojmë nga prokuroria, por edhe nga gjykata një ashpërsim të politikës së dënimit ndaj këtyre veprave penale, sepse ju i keni parë që të gjitha përpjekjet e qeverisë, qoftë për të luftuar rastet e vjedhjes së energjisë elektrike dhe janë jo më pak, por 100 milionë dollarë në vit që nuk arkëtohen në buxhetin e shtetit, të cilat do të shërbejnë për më shumë investime për të rritur qoftë pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve apo edhe pjesës tjetër të administratës.

Në lidhje me prokurorinë e Sarandës, besoj që kontrolli për ne ka qenë i plotë dhe janë bërë rekomandimet përkatëse dhe i takon prokurorit të Përgjithshëm, kur të vijë javën tjetër, të kthejë përgjigje lidhur me rekomandimet që i ka dërguar ministri i Drejtësisë dhe këndvështrimin e tij lidhur me këto rekomandime, pasi unë kam parë edhe në institucione të tjera që nuk e njohin dhe nuk duan që ta zbatojnë ligjin. Unë kam qenë korrekt në përcjelljen e raportit dhe rekomandimeve dhe i takon prokurorit të Përgjithshëm që të kthejë një përgjigje qoftë edhe negative lidhur me këtë raport.

Për sa u përket vendimeve të mosfillimit të procedimeve, unë nuk besoj se do të gjeni një praktikë të unifikuar në të gjitha prokuroritë pasi ndër vite ka ndryshime në procedurë dhe besoj se kjo i përket reformës dhe ndryshimeve që do të bëhen në Kodin e Procedurës Penale, sepse nuk mund ta gjejmë dot me rekomandime se ndryshe i zbaton Saranda, ndryshe Tirana apo dikush tjetër. Pra, nëse bëhen hetime disa mujore dhe më pas prokurori merr vendimin për mosfillimin e procedimit kjo është çështje e prokurorit të Përgjithshëm kur ka një urdhër apo veprime paraprake.

Rastet e mosfillimit të procedimit, në mos gabo, bëhen për një afat një muaj apo vazhdojnë mbi 6 muaj, por kjo nuk i përket më ministrit të Drejtësisë, por prokurorit të Përgjithshëm që urdhrin e nxjerrë prej tij nuk e zbatojnë vartësit e vet, pastaj pjesa tjetër është çështje e reformës.

Për sa i përket pyetjes tjetër lidhur me Gjykatën e Apelit Shkodër, kontrolli ka qenë i veçantë për shkak të politikës së dënimit dhe për sa kohë prokurori i shkallës së parë kërkon një masë dënimi, ankimon edhe ndaj vendimit të gjykatës dhe prokurori i Apelit, pa asnjë arsyetim nuk e mbështet kërkesën e prokurorit apo heq dorë nga kjo kërkesë unë besoj që kjo është mbështetë në një urdhër të prokurorit të Përgjithshëm dhe i takon atij të verifikojë nëse vartësit e zbatojnë apo nuk e zbatojnë urdhrin e tij. Ajo është çështje rekomandimi dhe është çështje që ne e kemi sugjeruar për një ashpërsim të politikës së dënimit dhe nuk mund të ndërhyjmë. Unë si ministër i Drejtësisë rast pas rasti përveçse të rekomandoj prokurorin e Përgjithshëm dhe t'i them që në këtë prokurori ne kemi konstatuar se kjo prokurori nuk funksionon si një e tërë shkallë parë me apelin apo me prokurorët pranë Gjykatës së Lartë dhe është çështje organizimit dhe funksionimit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera!

Besoj se për aq sa u diskutua bazuar edhe në raport situata është e qartë dhe secili nga deputetë ka vlerësimin përkatës. Pyetjet ishin në kontekstin e nevojës për të pasur më shumë vlerësim dhe me thënë të drejtën unë jam i shqetësuar nga fakti që prokurori i Përgjithshëm nuk dënon t'i kthejë përgjigje ministrisë së Drejtësisë për rekomandimet e sjella. Ky është një detyrim që e njeh ligji “Për prokurorinë e përgjithshme” e ka këtë obligim ndaj tij.

Në dijeninë time kjo është një gjë e përsëritur. Edhe vitin e kaluar është ngritur po i njëjti shqetësim dhe kjo nuk është serioze për një marrëdhënie ndërmjet institucione ligjzbatuese, por në

mënyrë të veçantë edhe për nevojën që së pari janë këto institucione që duhet të japin shembullin e respektimit të ligjit.

Së dyti, unë nuk jam plotësisht dakord me ministrin kur thotë që: “Mungesa e këtyre inspektimeve ose nevoja për me shumë inspektime ka lindur nga fakti për të mos pasur dublime apo për të më mos cenuar imazhin e qeverisë”. Ky është një detyrim që ia njeh ligji dhe për sa kohë ia njeh ligji askush nuk mund ta vërë në diskutim të drejtën e ministrit, të drejtën e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë për të inspektuar në gjykata apo për të inspektuar në prokurori. Por, ndërsa në gjykata siç e kuptova unë nga fjala e ministrit ka pasur një prioritet në rolin inspektues të ministrisë në sistemin e prokurorisë nuk ka qenë e njëjta pamje, ndërkohë që, realisht do të duhej të kishte pasur ehe më shumë inspektime edhe më shumë kontrole, natyrisht në kufijtë e ligjit dhe të detyrimeve që ai ka përcaktuar për natyrën e këtyre kontroleve për ligjshmërinë e tyre dhe për të shmangur çdo lloj selektiviteti në këtë proces.

Sot nuk ishte objekti ynë i diskutimit dhe besoj se pasi të dëgjojmë edhe raportin e prokurorit të Përgjithshëm do të ketë edhe një projekt- rezolutë dhe kjo do t’i paraqitet Kuvendit për të gjykuar në përgjithësi çështjen e politikave penale për vitin 2014 dhe për zbatimin legjislacionit në këtë fushë.

Unë do t’i kërkoja ministrit dhe natyrisht Shërbimit të Monitorimit për ta ndjekur si çështje dhe mundësisht brenda kësaj jave të na vërë në dispozicion të gjitha rekomandimet që Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë zyrës së prokurorit të Përgjithshëm nga fillimi i vitit, që ka të bëjë me prioritetet e politikës penale, por edhe rekomandimet që kanë ardhur si rrjedhojë e inspektimit që u trajtua këtu edhe nga kolegët, të cilat do të përfshihen në dosjen e punës së deputetëve gjatë debatit që do të bëhet për raportin e prokurorit të Përgjithshëm që do të bëhet në ditët në vazhdim.

A ka ndonjë njeri ndonjë gjë tjetër? Zoti Ministër, a mund ta mbyllim këtu? A keni ndonjë merak?

Faleminderit, zoti Ministër! Faleminderit, kolegë deputetë!

Punë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET

